



MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMEVE



RAPORT
I INSPEKTIMIT TË JASHTËZAKONSHËM MBI PËRDORIMIN E
AUTOMJETEVE POLICORE JASHTË ORARIT TË PUNËS

Nr. 7/2017

Prishtinë, 18 prill 2018

Informata të përgjithshme

Titulli	Raport i inspektimit të jashtëzakonshëm mbi përdorimin e automjeteve policore jashtë orarit të punës
Data e përgatitjes	18 prill 2018
Përgatitur nga	Ilir Idrizaj, mbikëqyrës i inspektimit, Fitore Gajraku, inspektor, Kadri Keçmezi, inspektor, Mirsad Puçurica, inspektor, Servet Tasholli, inspektor, Shqiponjë Sopi, inspektor, Teuta Rukolli-Ajeti, inspektor, Xhavit Fetahaj, inspektor
Mbikëqyrur nga	Ilir Idrizaj, mbikëqyrës i inspektimit, Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
Mbështetur nga	Bujar Mustafa Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
Dorëzuar nga	Bekim Pira Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miratuar nga	Miradije Kelmendi Ushtrues detyre i Kryeshënit Ekzekutiv Inspektorati Policor i Kosovës
Data e miratimit	18 prill 2018



1. Përmbledhja ekzekutive

1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit.....(4-4)

2. Hyrje

2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit.....(5-5)

2.2. Qëllimi i inspektimit.....(5-5)

2.3. Objekti dhe subjekti i inspektimit.....(5-5)

2.4. Objektivat e inspektimit.....(5-5)

2.5. Rëndësia e inspektimit.....(6-6)

2.6. Metodologjia e inspektimit.....(6-6)

2.7. Periudha e kryerjes dhe mbulimit të inspektimit.....(6-6)

2.8. Drejtimit dhe kriteret e vlerësimit.....(6-6)

2.9. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave.....(6-6)

3. Përshkrimi i objektit, gjetjet dhe rekomandimet

3.1. Baza ligjore për përdorimin e automjeteve jashtë orarit të punës(7-9)

3.2. Rezultatet e verifikimit të automjeteve të përdorura jashtë orarit.....(9-11)

4. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

4.1. Plani i veprimt për realizimin e rekomandimeve.....(12-13)

1. Përmbledhja ekzekutive

1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit

1.1.1. Për përmbushjen e mandatit të saj ligjor në sundimin e rendit dhe ligjit, Policia e Kosovës (PK) ka në dispozicion një numër kapacitetesh të burimeve njerëzore dhe teknike që i mundësojnë asaj kryerjen me sukses të aktiviteteve operative e mbështetëse. Në kuadër të kapaciteteve teknike, vend me rëndësi zënë edhe automjetet policore, menaxhimi i të cilave kërkon racionalitet por edhe përgjegjshmëri për shkak të kostos së lartë, qoftë të blerjes por edhe mirëmbajtjes. Përdorimi i tyre është i rregulluar me akte të ndryshme dhe nuk vërehet se baza ligjore mund të paraqes pengesë në përdorimin operativ të tyre. Përdorimi i automjeteve është i rregulluar me akt nënligjor të Qeverisë por edhe me akte tjera të brendshme policore, që këto të fundit janë mirë të harmonizuara me aktin e nxjerrë në nivel qeveritar.

1.1.2. Në bazë të Programit të punës inspektuese, Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) ka pasur për objekt inspektimi, përdorimin e automjeteve zyrtare policore jashtë orarit të rregullt të punës. Përdorimi i automjeteve zyrtare është i rregulluar me Udhëzimin Administrativ nr. 03/2008 për Përdorimin e Automjeteve të Qeverisë, Rregulloren për Personel e Administratë në Policinë e Kosovës dhe Doracakun e 'Parimeve dhe procedurave të Policisë'. Janë një numër automjeteve zyrtare policore që janë lejuar për përdorim jashtë orarit të rregullt të punës për shkak të natyrës specifike të punës. Sipas rregullit, automjetet policore që nevojiten të përdoren nga një numër pozitash menaxheriale dhe operative, duhet të miratohen nga Ministri i Punëve të Brendshme, pas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë. Ministri është autoriteti që miraton Listën e shfrytëzuesve, pas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm. IPK-ja ka arritur të sigurojë autorizimet e lëshuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, për automjetet zyrtare që mund të përdoren edhe jashtë orarit të punës, por jo edhe Listën e aprovuar nga autoriteti kompetent (Ministri).

1.1.3. IPK-ja në ditën e inspektimit ka verifikuar rreth 100 automjete të përdorura jashtë orarit, që u janë qasur parkingjeve policore në mëngjesin e ditës kur është realizuar ky inspektim. Një pjesë e konsideruar e përdoruesve të këtyre automjeteve policore, të përdorura jashtë orarit të rregullt të punës, kanë prezantuar autorizimet e vlefshme mbi shfrytëzimin e tyre konform lejes paraprake të lëshuar nga autoriteti vendimmarrës. Është identifikuar një numër autorizimesh me afat të skaduar, të prezantuara nga përdoruesit e automjeteve zyrtare policore edhe pse kishin vazhduar t'i përdorin ato jashtë orarit, me autorizime të pa azhuruara apo jo të ri-përtëritura. Janë identifikuar një numër përdoruesish që kanë shfrytëzuar automjetet për nevoja operative, qoftë hetimore, patrulluese apo aktivitete tjera mbështetëse. Lidhur me këtë, IPK ka zhvilluar një metodologji të punës inspektuese përmes të cilës ka verifikuar të gjitha rastet e përdorimit të automjeteve për qëllime zyrtare, duke siguruar dëshmi relevante që mbështesin shfrytëzimin racional të tyre. Është identifikuar edhe një numër përdoruesish që kanë shfrytëzuar automjetet zyrtare policore në mënyrë të pa autorizuar, duke nënkuptuar se nuk kanë patur autorizime për të përdorur automjetet jashtë orarit të rregullt të punës. Inspektimi ka vënë në pah se në ditën e inspektimit, çdo i nënti automjet policor që i është qasur parkingjeve policore dhe i cili është përdorur jashtë orarit të rregullt të punës, është përdorur pa autorizim. Këtë mënyrë të përdorimit të automjeteve zyrtare policore, IPK e cilëson si joracional dhe jo të përgjegjshëm, që i sjellë imazh negativ organizatës policore. Kjo dukuri e shfrytëzimit të tillë të automjeteve zyrtare policore ndikon në efikasitetin, efektivitetin dhe leverdinë ekonomike të shfrytëzimit të këtyre aseteve të siguruar nga taksat e qytetarëve të vendit.

2. Hyrje

2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit

2.1.1. Në bazë të Ligjit nr. 03/L-231, IPK-ja ka mandat ligjor që të kryejë inspektime në Policinë e Kosovës, për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave policore. Ky aktivitet ndihmon dhe mbështetë Policinë, për të siguruar një shërbim profesional, demokratik dhe të përgjegjshëm. Veç inspektimeve të rregullta që organizohen bazuar në Planin Vjetor të Inspektimeve, IPK-ja zhvillon edhe inspektime të jashtëzakonshme që mund të rrjedhin si kërkesë e Kryeshefit Ekzekutiv dhe Ministrit të Punëve të Brendshme. Bazuar në këtë, me datë 08.11.2017, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së ka kërkuar inicimin e një inspektimi të jashtëzakonshëm mbi përdorimin e automjeteve zyrtare. Kjo kërkesë ka rrjedhë si rezultat i informacioneve se automjetet nuk janë duke u shfrytëzuar në mënyrën më efektive dhe më të përgjegjshme. Vlerësimi i menaxhimit të kësaj fushe paraqet interes për Departamentin e Inspektimit, sepse bartë një risk të lartë për keq-menaxhim dhe keqpërdorim eventual në përdorimin e automjeteve, të përcjellur me kosto të lartë financiare. Duhet kuptuar se kjo fushë është e ndjeshme dhe paraqet një nga investimet më të kushtueshme të organizatës.

2.2. Qëllimi i inspektimit

2.2.1. Qëllimi i inspektimit është:

- Që të përcaktojë nëse ligjet, rregulloret dhe parimet e procedurat e brendshme policore përkatëse zbatohen si duhet dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet policore,
- Që të përcaktojë nëse burimet policore shfrytëzohen në mënyrë efektive, efektive dhe nëse janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat,
- Që të jepet opinion objektiv mbi çështjet që lidhen me fushën e përdorimit të automjeteve,
- Që të parandalojë shkeljet eventuale që mund të kryhen gjatë punës në fushën përkatëse,
- Të identifikojë mangësitë apo dobësitë dhe të rekomandojë masa ligjore dhe organizative për funksionimin më të mirë të PK-së.

2.3. Objekti dhe subjekti i inspektimit

2.3.1. Në këtë inspektim është vlerësuar respektimi i rregullave mbi përdorimin e automjeteve jashtë orarit të punës dhe është përqendruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës (DPP), departamentet policore dhe drejtoritë rajonale policore (DRP).

2.4. Objektivat e inspektimit

2.4.1. Objektivat që ka synuar t'i arrijë ky inspektim janë:

- Të vlerësohet respektimi i bazës ligjore mbi lejimin e përdorimit të automjeteve policore jashtë orarit zyrtar të punës,
- Të vlerësohet respektimi i Listës së autorizuar të përdorimit të automjeteve jashtë orarit zyrtar të punës.

2.5. Rëndësia e inspektimit

2.5.1. Inspektimi në këtë fushë të menaxhimit luan rol të rëndësishëm në:

- Ushtrimin e një kontrolli më të rreptë për të siguruar shkallë më të lartë ekonomizimi, efikasiteti dhe levërdie ekonomike në përdorimin e automjeteve,
- Ngritjen e përgjegjësisë së punonjësve policorë në përdorimin e duhur të automjeteve,
- Parandalimin e përdorimit të pa përgjegjshëm dhe jo racional të automjeteve,
- Ngritjen e besimit mbi shfrytëzimin e mjeteve të siguruara nga taksapaguesit.

2.6. Metodologjia e inspektimit

2.6.1. Gjatë inspektimit:

- a) Janë zhvilluar takime me punonjës për verifikimin e përdorimit të automjeteve,
- b) Janë verifikuar automjetet për t'u identifikuar përdorimi i tyre gjatë ditës së inspektimit,
- c) Janë plotësuar formularët mbi identifikimin dhe verifikimin e automjeteve të përdorura,
- d) Janë siguruar dokumente fizike mbi përdorimin e automjeteve zyrtare.

2.7. Periudha e kryerjes dhe mbulimit të inspektimit

2.7.1. Bazuar në Programin e punës inspektuese, inspektimi i jashtëzakonshëm ka filluar dhe është përmbyllur më 21.11.2017. Natyra e këtij inspektimi ka qenë ad hoc dhe përmes tij është verifikuar përdorimi i automjeteve në ditën e inspektimit.

2.8. Drejtimet dhe kriteret e vlerësimit

2.8.1. Për përmbushjen e objektivave, inspektimi është përqendruar në këto drejtime kryesore:

- Baza ligjore që rregullon përdorimin e automjeteve jashtë orarit zyrtar të punës, dhe
- Rezultatet e verifikimit të automjeteve të përdorura jashtë orarit zyrtar të punës.

2.8.2. Dokumentet në vijim janë baza, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve:

- Ligji për Policinë,
- Udhëzimi Administrativ për përdorimin e automjeteve të Qeverisë së Kosovës (03/2008),
- Rregullorja për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës,
- Doracaku i 'Parimeve dhe procedurave të Policisë',
- Autorizimet për përdorimin e automjeteve zyrtare jashtë orarit të punës.

2.9. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave

2.9.1. IPK-ja vlerëson se gjatë punës në terren dhe pasqyrimin të gjetjeve në raportin e zgjeruar të inspektimit, nuk janë paraqitur vështirësi të natyrës objektive, të cilat kanë mundur të kenë ndikim në realizimin e objektivave të përcaktuar me Programin e punës inspektuese.

3. Përshkrimi i objektit, të gjeturat dhe rekomandimet

3.1. Baza ligjore që rregullon përdorimin e automjeteve jashtë orarit zyrtar të punës

3.1.1. Policia është një organizatë e madhe në forcimin e sundimit të rendit dhe ligjit, dhe si e tillë ka në dispozicion burime njerëzore të strukturuar sipas një skeme organizative të shtrirë në tërë territorin. PK-ja ka edhe kapacitete tjera të natyrës teknike dhe infrastrukturore që i mundësojnë asaj përmbushjen e detyrave që dalin nga mandati i saj ligjor. Është më se e nevojshme që për një menaxhim më racional dhe më të përgjegjshëm të këtyre kapaciteteve policore, PK-ja duhet t'iu përmbahet procedurave dhe dispozitave ligjore që rregullojnë fushat përkatëse. Edhe automjetet policore janë pasuri me rëndësi vitale për funksionimin e duhur policor dhe përmbushja e mandatit ligjor në krijimin e një ambienti më të sigurtë, është në masë të konsideruar i kushtëzuar edhe nga kapacitetet teknike që kërkojnë një menaxhim adekuat.

3.1.2. Gjatë inspektimit janë identifikuar rregullat, si dhe procedurat që e përcaktojnë mënyrën e përdorimit të automjeteve zyrtare jashtë orarit zyrtar të punës. Dispozitat që rregullojnë mënyrën e përdorimit të automjeteve zyrtare, gjatë dhe jashtë orarit të rregullt të punës, rrjedhin nga Ligji nr. 04/L-076 për Policinë, me çka përcaktohen në mënyrë të përgjithshme detyrat dhe autorizimet policore për përmbushjen e mandatit ligjor. Në bazë të këtij Ligji, zyrtarët policorë kanë autorizime të ushtrojnë kontroll të arsyeshëm mbi njerëzit dhe pronën, në kuadër të kompetencave, si dhe autorizimeve të tyre. Autorizimet e cekura në këtë Ligj përcaktojnë autorizimet e përgjithshme dhe kufizimet e zyrtarëve policorë në kryerjen e detyrave të tyre lidhur me parandalimin e rrezikut dhe mbajtjen e rendit dhe të sigurisë publike. Këto autorizime policore, zyrtarët policorë i ushtrojnë si gjatë orarit të rregullt të punës, po ashtu edhe jashtë orarit të punës.

3.1.3. Si legjislacion primar për këtë fushë ekzistojnë edhe një mori aktesh nënligjore, me të cilat rregullohet natyra dhe specifikat e posaçme të punës policore, përfshirë edhe mënyrën e përdorimit të automjeteve gjatë dhe jashtë orarit të rregullt të punës. Udhëzimi Administrativ nr. 03/2008 për Përdorimin e Automjeteve të Qeverisë përcakton mënyrën e lejimit të përdorimit të automjeteve zyrtare jashtë orarit të punës, për rastet e caktuara për shkak të specifikave të posaçme të punës së institucioneve të caktuara. Akt tjetër i brendshëm i PK-së është edhe Rregullorja për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës, që përcakton rregullat mbi shfrytëzimin efikas, ekonomik dhe racional të automjeteve zyrtare. Rregullorja përcakton se përveç gjatë orarit të rregullt të punës, automjetet zyrtare mund të përdoren edhe jashtë orarit të punës, me leje përkatëse dhe me autorizim nëse një gjë të tillë e kërkojnë nevojat e shërbimit. Doracaku 'Parimet dhe procedurat e Policisë' në parimin P-10.01 përcakton rregullat mbi shfrytëzimin e automjeteve policore. Vlerësuar në aspektin formalo-juridik, infrastruktura ligjore policore mbi shfrytëzimin e automjeteve zyrtare është mjaft e kompletuar dhe e harmonizuar. Kjo bazë ligjore u mundëson drejtuesve, ushtrimin e një kontrolli adekuat mbi shfrytëzimin e automjeteve zyrtare në mënyrën më të duhur, duke ofruar edhe ngritje të nivelit të llogaridhënies. Me këtë rast, IPK çmon angazhimet e drejtuesve policorë në nxjerrjen e gjithë rregullativës ligjore që rregullon këtë fushë.

3.1.4. Të gjeturat e inspektimit kanë identifikuar autoritetet vendimmarrëse që përcaktojnë kushtet nën të cilat duhet të shfrytëzohen automjetet zyrtare policore dhe subjektet që mund t'i shfrytëzojnë ato edhe jashtë orarit të rregullt të punës. Me Udhëzimin Administrativ nr. 03/2008 për Përdorimin

e Automjeteve të Qeverisë¹ është përcaktuar që në raste të caktuara, për shkak të specifikave të posaçme të punës, me vendim të ministrit të ministrisë përkatëse, mund të lejohet përdorimi i automjeteve zyrtare edhe jashtë orarit zyrtar të punës, me propozim të sekretarit të përhershëm, kryeshefit ekzekutiv apo udhëheqësit më të lartë të organizatës buxhetore të institucionit përkatës. Këto dispozita ligjore, PK-ja i ka inkorporuar në Doracakun ‘Parimet dhe Procedurat e Policisë’, në parimin P-10.01 (Shfrytëzimi i Automjeteve të Policisë së Kosovës). Në paragrafin A, pika 3, është përkufizuar që ‘në bazë të Udhëzimit Administrativ nr. 03/2008, me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës dhe aprovim të Ministrit të Punëve të Brendshme, aprovohet lista për përdorimin e automjetëve zyrtare edhe jashtë orarit zyrtar të punës’ Edhe përkundër faktit se ky Parim ishte shfuqizuar me Rregulloren nr. 28/2015, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë vazhdon të thirret në dispozitat e këtij parimi në kuadër të preambulës së autorizimeve të lëshuar për lejimin e automjeteve zyrtare për punë zyrtare edhe pas orarit zyrtar të punës. Nga të dhënat e mbledhura, në kuadër të Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë nuk është hasur se ekziston Listë e automjeteve zyrtare, e cila është propozuar nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm dhe miratuar nga ana e Ministrit të Punëve të Brendshme për përdorimin e automjeteve zyrtare edhe jashtë orarit zyrtar të punës. Edhe pse dispozitat e këtij Udhëzimi janë obligative, nuk shihet se janë zbatuar procedurat dhe rregullat nga autoriteti i përcaktuar lidhur me propozimin dhe aprovimin e Listës për lejimin e përdorimit të automjeteve zyrtare jashtë orarit të rregullt të punës.

Rekomandimi nr. 1

IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë që në të ardhmen të zbatojë dispozitat e nenit 3, paragrafi 3.3 të Udhëzimit Administrativ nr. 03/2008 për Përdorimin e Automjeteve të Qeverisë, lidhur me lejimin e automjeteve zyrtare policore edhe jashtë orarit të punës, për shkak të specifikave të posaçme të punës.

3.1.5. Me dispozitat e nenit 151, paragrafi 4 të Rregullorës për Personel dhe Administratë, citohet se ‘Automjetet e Policisë duhet të shfrytëzohen vetëm për qëllime zyrtare. Përveç gjatë orarit të rregullt të punës, automjetet zyrtare mund të përdoren edhe jashtë orarit të punës, nëse një gjë të tillë e kërkojnë nevojat operacionale dhe nevojat tjera të shërbimit’. Në inspektim janë identifikuar dokumentet e prodhuara nga autoriteti vendimmarrës policor mbi përdoruesit e autorizuar të automjeteve policore jashtë orarit zyrtar të punës. Në nenin 152, paragrafi 1 të kësaj Rregulloreje, ku përcaktohet autorizimi për ngasjen e automjetit zyrtar, citohet se ‘Zyrtarët policorë me leje përkatëse dhe me autorizim kanë të drejtë që t’i ngasin automjetet e Policisë’. Bazuar në këtë, varësisht prej nevojave operative të departamenteve, divizioneve apo drejtorive operative policore, këto janë të obliguara t’i parashtrajnë kërkesa të shkruara Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, për numrin e automjeteve apo pozitive për dhënien e autorizimeve për përdorim të automjeteve zyrtare jashtë orarit të punës për nevoja zyrtare. Bashkë me kërkesa duhet të parashtrohen edhe arsyetimet e bazuara që mbështesin nevojën e lëshimit të autorizimeve. Në kuadër të Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm është siguruar Lista e autorizimeve të lëshuara për pozita të caktuara drejtuese dhe pozita operative, për përdorim të automjeteve zyrtare jashtë orarit të punës për nevoja zyrtare. Më 21 dhjetor 2017, nga Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë janë siguruar 98 autorizime valide për automjete zyrtare që mund të përdoren për punë zyrtare edhe jashtë orarit të punës, që u janë

¹ Qeveria e Kosovës, Udhëzimi Administrativ nr. 03/2008 për Përdorimin e Automjeteve të Qeverisë, neni 3, Prishtinë, 2008.

lëshuar pozitive të caktuara operative brenda strukturës së departamenteve, drejtorive apo njësive policore.

3.1.6. Bazuar në kërkesat e parashtruara nga departamentet, divizionet apo drejtoritë policore për lëshimin e autorizimeve për përdorim të automjeteve zyrtare edhe jashtë orarit të rregullt të punës, Vendimin e Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 263, të datës 9 maj 2008 dhe Parimin P-10-01, për përdorimin e automjeteve zyrtare jashtë orarit zyrtar të punës, paragrafin III-A/6, (parim ky i shfuqizuar me Rregulloren nr. 28/2015), Drejtori i Përgjithshëm i Policisë lëshon autorizime, me të cilat autorizohen automjetet me numër dhe të cilat i përkasin pozitive specifike policore, të cilat mund të përdoren vetëm për punë zyrtare edhe pas orarit zyrtar të punës. Në bazë të këtyre autorizimeve, ngasësit që janë bartës të tyre janë të obliguar të mbajnë në librat e dokumenteve të automjeteve, këto autorizime gjatë ngasjes së automjeteve jashtë orarit zyrtar. Autorizimet lëshohen për një periudhë 12 mujore dhe se dhjetë (10) ditë para skadimit të afatit, bartësit e tyre përmes zinxhirit komandues duhet të parashtrojnë kërkesat e tyre për zëvendësimin apo ripërtëritjen me autorizime të reja. Afatizimi i periudhës kohore për lëshim të autorizimeve, i mundëson menaxhmentit policor që të ushtrojë kontroll periodik dhe vlerësojë arsyeshmërinë e nevojave për vazhdimin apo ndërprerjen e autorizimeve. Vendimi i Ministrit të Punëve të Brendshme i datës 9 maj të vitit 2008 nuk është arritur të sigurohet gjatë inspektimit as në kuadër të strukturës policore të inspektuar, as në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB). Edhe përkundër faktit se DPP vazhdon të nxjerrë autorizime për përdorimin e automjeteve jashtë orarit të punës duke iu referuar këtij vendimi, përmbajtja e tij mbetet e panjohur për IPK-në.

3.2. Rezultatet e verifikimit të automjeteve të përdorura jashtë orarit të punës

3.2.1. Bazuar në numrin e konstatuar të automjeteve të përdorura jashtë orarit zyrtar të punës, në mëngjesin e hershëm të datës 21 nëntor 2017, në kuadër të DPP-së, në tetë (8) drejtoritë rajonale policore (DRP) dhe tre (3) drejtoritë rajonale policore kufitare (DRPK), janë evidentuar gjithsejt 99 automjete zyrtare, të cilat iu kanë qasur parkingjeve policore në intervalin kohor prej orës 07.30 deri në 09.00. Prej 99 automjeteve të evidentuara që kanë lëvizur gjatë natës së 20 nëntorit apo mëngjesit të 21 nëntorit të vitit 2017 kur edhe është zhvilluar inspektimi, për 31 prej tyre (31.3%) janë ofruar dëshmi se të njejtat janë shfrytëzuar mbi bazën e autorizimeve valide të lëshuara nga autoriteti kompetent. IPK-ja çmon lartë të gjitha përpjekjet e zyrtarëve policorë në respektimin e rregullave dhe autorizimeve ligjore gjatë përdorimit të automjeteve. Ky përkushtim jep rezultate pozitive për performancën policore duke i kontribuar menaxhimit më efektiv, efikas dhe ekonomik gjatë shfrytëzimit të resurseve dhe ngritjes së llogaridhënies. IPK inkurajon ngasësit që në mënyrë permanente të operojnë në pajtim me rregullat dhe autorizimet ligjore.

3.2.2. Siç është potencuar më lartë, autorizimet për përdorim të automjeteve zyrtare janë lëshuar për periudhë kohore 12 mujore. Prej 99 automjeteve të evidentuara gjatë inspektimit, për nëntë (9) prej tyre apo (9%), ngasësit e tyre në kohën e inspektimit kanë prezantuar autorizime me afat të skaduar. Deri te kjo gjendje ka ardhur si rezultat i neglizhencës së zyrtarëve të caktuar policorë për të parashtruar me kohë kërkesat me arsyetimet për nevojat përdorimit të automjeteve zyrtare jashtë orarit të punës dhe lëshimit apo zëvendësimit të autorizimeve. Në këto raste të evidentuar, ngasësit kanë shfrytëzuar automjetet policore jashtë orarit të rregullt të punës, pa autorizime të vlefshme. Kjo situatë ka efekt negativ ngase lenë hapësirë për keqkuptime, duke mos qartësuar se cilat janë arsyet e mos azhurimit me kohë të këtyre autorizimeve.

Rekomandimi nr. 2

IPK-ja u rekomandon të gjithë zyrtarëve policorë si bartës të pozitive operative që shfrytëzojnë automjete zyrtare për punë zyrtare edhe jashtë orarit të punës, që të parashtrojnë me kohë kërkesat dhe arsyetimet e tyre për vazhdimin, zëvendësimin apo ri-përtëritjen e autorizimeve për ngasje.

3.2.3. Ligji nr. 04/L-076 për Policinë përcakton saktë se zyrtarët policorë janë të thirrur të mbrojnë jetën, pronën dhe të ofrojnë siguri për të gjithë personat, mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të të gjithë personave, të parandalojnë rrezikun ndaj qytetarëve, të mbajnë rendin dhe sigurinë publike, të parandalojnë dhe zbulojnë veprat penale dhe kryesit e tyre, të hetojnë veprat penale dhe kryesit e tyre, të mbikëqyrin dhe të kontrollojnë sigurinë në komunikacion, të menaxhojnë dhe kontrollojnë kufirin shtetëror, të ofrojnë ndihmë gjatë fatkeqësive natyrore dhe në raste të tjera emergjente, si dhe të kryejnë detyra të tjera të parapara me ligjin në fuqi. Për t'i realizuar këto autorizime dhe detyra, Policia duhet të ketë në dispozicion burime njerëzore dhe materiale, të cilat i mundësojnë të jetë e gatshme për reagim dhe ballafaqim me situata të ndryshme që kërkojnë veprime pro-aktive dhe reaktive gjatë 24 orëve. Nga 99 automjetet policore të evidentuara në ditën e inspektimit, është konstatuar se 48 sosh apo 48.5% prej tyre janë arsyetuar dhe verifikuar se janë përdorur në kuadër të realizimit të planeve operative, reagimeve operative si rrjedhojë e hetimeve në proces apo situatave tjera të krijuara. Dokumentet relevante që kanë mbështetë këto nevoja apo arsyeshmërinë e përdorimit të automjeteve zyrtare policore jashtë orarit të punës kanë qenë planet operative, rastet hetimore dhe oraret apo agjendat e aktiviteteve, të cilat kanë zgjatur përtej orëve të mbrëmjes së 20 nëntorit të vitit 2017.

3.2.4. Inspektorët kanë identifikuar edhe një numër rastesh kur automjetet policore zyrtare janë përdorur jashtë orarit të rregullt të punës dhe nuk janë arsyetuar me dëshmi relevante se përdorimi i tyre ka qenë i autorizuar për shkak të angazhimeve operative. Prej 99 automjeteve policore të identifikuar që janë përdorur jashtë orarit të rregullt të punës në ditën e inspektimit, përdoruesit e 11 prej tyre (11%), nuk kanë prezentuar dëshmi se i kanë përdorur ato mbi bazën e autorizimeve, angazhimeve në kuadër të planeve operative apo orareve zyrtare të punës². Përdorimi i automjeteve zyrtare jashtë autorizimeve ligjore nga punonjësit policorë sjellë inpute negative në menaxhimin e mirë ekonomik, duke shkaktuar ngarkesë kostove që paguhet nga buxheti i organizatës. Kjo situatë vë në pah tendencën se jo gjithëherë automjetet zyrtare policore përdoren në mënyrë të arsyeshme. Andaj, duhet ndër marrë hapat e nevojshëm menaxherial në ushtrimin e një kontrolli më rigoroz mbi përdorimin e automjeteve zyrtare policore jashtë orarit të rregullt të punës, për t'u siguruar se këto asete përdoren në mënyrë racionale dhe të përgjegjshme. Një nga mënyrat më efikase për të ushtruar një kontroll efektiv mbi përdorimin e automjeteve policore është mobilizimi i drejtuesve në organizimin e kontrolleve të shpeshta të automjeteve. Drejt disiplinimit të shkelësve të akteve ligjore në fuqi që përcaktojnë mënyrën e përdorimit të automjeteve, duhet inicuar edhe procedura të brendshme disiplinore ndaj atyre që keqpërdorin automjetet policore për qëllime jozyrtare.

² Lista e përpiluar me rastet e përdorimit të pa autorizuar të automjeteve zyrtare policore i është dorëzuar Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë. Lista e tillë përmban të dhëna mbi përdoruesit, llojin dhe targat e automjeteve, si dhe njësitë përdoruese. Lista i referohet ditës kur është zhvilluar inspektimi i jashtëzakonshëm nga IPK-ja.

Rekomandimi nr. 3

IPK-ja u rekomandon drejtuesve policorë që të shtojnë përpjekjet e tyre për të ushtruar kontrollin e nevojshëm për përdorimin racional dhe të përgjegjshëm të automjeteve zyrtare jashtë orarit zyrtar të punës, në pajtim me aktet ligjore dhe Listën e autorizuar nga autoriteti vendimmarrës.

3.2.5. Për verifikimin e rregullësisë së përdorimit të automjeteve zyrtare është specifikuar i tërë dokumentacioni që ka mbështetur aktivitetet dhe angazhimet policore. Inspektorët kanë kryer verifikimin e përdorimit të automjeteve bazuar në: Listën e autorizimeve të automjeteve zyrtare për përdorim jashtë orarit zyrtar të punës, autorizimet e lëshuara nga DPP-ja, planet operative që dëshmojnë angazhimin e punonjësve policorë në detyra konkrete operative, oraret e ndërrimeve, dëshmi të rasteve hetimore në process dhe deklarata të zyrtarëve policorë të angazhuar në aktivitete policore gjatë mbremjës së 20 nëntorit dhe mëngjesit të 21 nëntorit 2017.

4. Plani i përmbushjes së rekomandimeve

4.1. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

4.1.1. Mbi bazën e gjetjeve, IPK-ja ka dhënë një numër rekomandimesh dhe pas komenteve të ofruara nga menaxhmenti policor në takimin përmbyllës të datës 05.04.2018, është vendosur që ato të realizohen sipas Planit të veprimit të prezantuar në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Rekomandimi	Prior	Komentet e strukturës policore	Plani veprues
1.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë që në të ardhmen të zbatojë dispozitat e nenit 3, paragrafi 3.3 të Udhëzimit Administrativ nr. 03/2008 për Përdorimin e Automjeteve të Qeverisë, lidhur me lejimin e automjeteve zyrtare policore edhe jashtë orarit të punës, për shkak të specifikave të posaçme të punës.</i>	<i>I</i>	<i>Zyra Ligjore e PK-së vlerëson se kjo çështje rregullohet me Ligjin për Polici dhe Rregulloren për Personel e Administratë. Zbatimi i rekomandimit me përdorimin e automjeteve jashtë orarit të punës në mënyrën siç është kërkuar do të shkaktonte vështirësi të caktuara të realizimit me sukses dhe me kohë të planeve operacionale sidomos kur kemi të bëjmë me detyra të natyrës urgjente që nuk mund të realizohen pa përdorimin e automjeteve zyrtare duke pasur operasysh me këtë rast sidomos dispozitat e nenit 5 paragrafit 1 të Ligjit për Policinë.³</i>	<i>-</i>
2.	<i>IPK-ja u rekomandon të gjithë zyrtarëve policorë si bartës të pozitave operative që shfrytëzojnë automjetet për punë zyrtare edhe jashtë orarit, që t'i parashtrajnë me kohë kërkesat dhe arsyetimet e tyre për vazhdimin, zëvendësimin apo ri-përtëritjen e autorizimeve për ngasje.</i>	<i>I</i>	<i>Është në zbatim e sipër.</i>	<i>30 ditë</i>
3.	<i>IPK-ja u rekomandon drejtuesve policorë që të shtojnë përpjekjet e tyre për të ushtruar kontrollin e nevojshëm për përdorimin racional dhe të përgjegjshëm të automjeteve zyrtare jashtë orarit zyrtar të punës, në pajtim me aktet ligjore dhe Listën e autorizuar nga autoriteti vendimmarrës.</i>	<i>I</i>	<i>Është në zbatim e sipër.</i>	<i>30 ditë</i>

³ **Sqarim:** IPK-ja vlerëson se me Udhëzimin Administrativ nr. 03/2008 për Përdorimin e Automjeteve të Qeverisë, nuk përjashtohen së zbatuari dispozitat për asnjë institucion, agjencion apo organizatë buxhetore. Përmes realizimit të këtij inspektimi, IPK nuk ka pasur synim të afektoj në kufizimin e punës dhe autorizimeve policore. Për të gjitha rastet e ngasjes së automjeteve zyrtare të evidentuar në ditën e inspektimit është vlerësuar baza e arsyeshmerisë së përdorimit të tyre. Për të gjitha rastet kur përdoruesit e tyre jashtë orarit zyrtar të punës kanë pasur autorizime të valide, leje të posaçme apo kanë dëshmuar se janë përfshirë në angazhime operative, IPK ka verifikuar situatat apo rastet dhe më pas ka vlerësuar arsyet e përdorimit.

